



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

INTERVISTA E KRYETART TË PREZENCËS SË OSBE-SË NË SHQIPËRI, AMBASADORIT BERND BORCHARDT, PËR ÇËSHTJE TË MEDIAS

Dhënë më 3 maj 2019

Intervistoi: Mimoza Picari - Zëri i Amerikës

VoA: Z. Ambasador, në Shqipëri, një nga fushat problematike është edhe media, me të gjitha problemet e saj. OSBE-ja e ka ndjekur hap pas hapi median, lirinë e saj dhe raportin çdo vit në Vjenë për këtë çështje. Unë do të doja të dija një vlerësim të përgjithshëm të OSBE-së për median në Shqipëri.

Ambasadori Borchardt: Situata ka disa aspekte. Burimet tona janë, së pari, vëzhgimi që i bëjmë medias dhe, së dyti, ajo që burimet e tjera prestigjioze thonë për median.

Përshtypja ime e parë, me shqipen time të kufizuar, bazohet kryesisht në kanalet informative, në pamjet që shoh dhe në tekstet që lexoj në to. Aty kuptoj se skena e medias është shumë e ndarë. Është e vështirë të marrësh informacion të paanshëm. Kur dua të krijoj një pamje të plotë, më duhet të shikoj kanale të ndryshme dhe të lexoj lajme të ndryshme. Ose le të marrim raportimin për protestat. Mediat që janë miqësore me njërën palë, i vendosin kamerat në pozicion të tillë që të tregojnë një turmë të madhe njerëzish. Mediat që janë miqësore me palën tjetër, përdorin dronin për të treguar se kishte shumë pak njerëz. Ky pasqyrim nuk është i balancuar brenda kanaleve, ai është i njëanshëm.

Një aspekt tjetër i përkeqësimit të gjendjes së medias, është se mjaft raportime bazohen në atë çka prodhon politika, në Facebook, në kronikat e parapërgatitura etj., në vend që të bazohen në investigimet e vetë gazetarëve.

Ndër burimet dytësore që përdorim për gjendjen e medias, sigurisht Reporterët pa Kufi janë gjykatësi kryesor ndërkombëtar për median. Shqipëria ka qenë e pozicionuar mjaft mirë, në vendin e 62-të, por kjo ishte 13 vjet më parë. Deri në vitin 2013, pamë një përkeqësim të madh, Shqipëria ra nga vendi i 62-të në vendin e 102-të. Pas vitit 2013, pati sërish ngritje, deri vitin e kaluar, dhe tani ka sërish përkeqësim. Pra, kemi pasur përmirësim dhe më pas përkeqësim.

Cilat janë problemet tani? Ku i shohim problemet kryesore? Është çështja e vetëcensurës. Shumë gazetarë na thonë se ndihen nën presion nga pronarët e medias, se ka ndërhyrje nga ana e pronarëve. Shpesh, gazetarët nuk kanë kontrata të mirëfillta, pagesat janë të parregullta, pra gjendja është e pasigurt. Di që komisioni parlamentar i mjeteve të informimit publik po merret me këtë çështje. Zgjidhja e saj nuk është shkencë. Mjafton të zbatohet Kodi i Punës. Nuk është nevoja të rishpikim rrotën. Kuvendi duhet të ushtrojë presion për këtë.

Në përgjithësi, ky trekëndëshi media, politikë dhe biznes është mjaft problematik. Interesat e biznesit, sigurisht, duan që të mbrohen. Kjo ndikon në cilësinë e medias.

Kufizimi i pronësisë në media u shfuqizua nga Gjykata Kushtetuese, por kjo nuk e pengon Kuvendin të gjejë një mënyrë të pranueshme për ta kufizuar sërish pronësinë në media.

Pastaj është problemi i dhunës. Në vendet fqinjë është shumë më i dukshëm, por ndodh edhe këtu dhe është një gjë shumë e keqe. Kemi pasur disa sulme kundër gazetarëve që kanë qenë kërcënuese.

Aspekti i tretë ka të bëjë me sulmet verbale kundër medias, të cilat për mua janë të tepruara. Nga ana tjetër, shoh zemërimin që qëndron pas tyre dhe ky zemërim vjen nga shpifjet dhe lajmet e rreme. E dimë mirë se për çfarë po flasim, pasi edhe ne kemi qenë objekt shpifjesh. Rrugëdalja është shumë e ngushtë, sepse ecim në mes dy të drejtave të njeriut: të drejtës për lirinë e fjalës dhe të drejtës për mbrojtjen e dinjitetit. Qeveria ka hartuar një projektligj dhe jemi të lumtur që ky projektligj po konsultohet me ekspertët tanë. Do të ishte fantastike sikur produkti përfundimtar të ishte në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare. Shqipëria do të ketë Kryesinë e Radhës të OSBE-së vitin e ardhshëm dhe, kështu, mund të kthehet në një shembull pozitiv se si i jepet zgjidhja e duhur kësaj çështjeje, pra, se si mund të gjendet ekuilibri i duhur mes lirisë së fjalës, lirisë së medias dhe mbrojtjes së dinjitetit njerëzor. Shpresoj se kjo do të funksionojë.

Disa rekomandime që ne sigurisht do t'i bëjmë janë të lidhura me dekriminalizimin e shpifjes, pra heqjen e saj nga Kodi Penal. Sipas pikëpamjes sonë, shpifja është një çështje që i takon kodit civil dhe jo atij penal. Një tjetër rekomandim ka të bëjë me kufizimin e përdorimit të kronikave të parapërgatitura, sidomos gjatë zgjedhjeve. Më së paku, ato duhet të identifikohen qartë se janë produkt i partive politike dhe jo produkt gazetaresk.

Në përgjithësi, e shohim gjendjen e medias në kuadër të klimës së përkeqësuar politike, e cila ka ndikim mbi tërë situatën. Shohim një përkeqësim të situatës jo vetëm në fushën e medias. Citova më herët renditjen e Shqipërisë në raportin e Reporterëve pa Kufij. I njëjtë është edhe përkeqësimi në renditjen e Transparency International për korrupsionin. Pas vitit 2013, gjërat u përmirësuan. Tani gjërat janë përkeqësuar sërish, jo aq keq sa në vitin 2013, por ka pasur përkeqësim. Po ashtu, vërejtëm një përmirësim mjaft të ndjeshëm në klimën e investimeve, por edhe këtu ka sërish përkeqësim. Mendoj se të tëra këto kanë lidhje me klimën politike negative.

VoA: Folëm për trekëndëshin biznes, media dhe politikë. Çështja e pronësisë në media ka marrë shumë vëmendje kohët e fundit, pasi ka shumë akuza për financime të errëta të medias, bazuar në sondazhe dhe studime. Tregu i reklamave është diku te 40 milionë euro në vit, ndërkohë që në media gjenerohet shumë më tepër para se kaq. Kjo ka shtuar dyshimet dhe akuzat, duke filluar që nga eksponentë të qeverisë siç janë kryeministri dhe ish-ministri i Brendshëm, madje akuza të tipit që ka media që financohen nga krimi i organizuar, ashtu siç ka që disa pronarë të medias i përdorin këto media për shantazhe, për gjoba, ose për të shtuar pasuritë në kompani të tjera. Keni një vlerësim për këtë?

Ambasadori Borchardt: Përmendët dy probleme të ndryshme. Njëri është problemi i krimit dhe ky është problem që i përket policisë, prokurorisë dhe gjykatës. Ky nuk është shumë problem mediatik, është problem i krimit. Çështjen tjetër, e përmenda më parë: përqendrimi i pushtetit në fushën e medias. Gjykata Kushtetuese e ka shfuqizuar dispozitën ligjore që kufizonte pronësinë në media, por kjo nuk duhet ta pengojë Kuvendin të kërkojë mënyra të tjera për të garantuar pluralizmin në fushën e medias. Ne jemi të gatshëm të punojmë me Komisionin kuvendor për këto çështje, ashtu sikurse po punojmë për ligjin për shpifjen.

Fund